

Hazret Mirza Masrur Ahmed[aba],
Kalif i Pestë i Xhematit Musliman Ahmedia

**“Në botë paqja mund të vendoset vetëm nëse çdokush e njeh Zotin dhe kupton se duke e dashur Krijuesin, ai mund të dojë krijesat e Tij”.**

(Hazret Mirza Masrur Ahmed[aba], revista “The Review of Religions”, Londër, qershor 2007, f. 21)

**“Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën, si ajo që u jepet të afërmve, dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të kuptoni”.**

(Kurani Famëlartë 16:91)

**“O ju që besuat, bëhuni të qëndrueshëm ndaj drejtësisë, duke e dëshmuar atë për hir të Allahut edhe sikur ajo dëshmi të jetë kundër vetes suaj, kundër prindërve apo të afërmve (tuaj). Qoftë i pasur, qoftë i varfër, Allahu është kujdestari më i mirë për të dy. Mos ndiqni dëshirat (tuaja) e t'i shmangeni drejtësisë”!**

(Kurani Famëlartë 4:136)

## Xhemati Musliman Ahmedia

Xhemati Musliman Ahmedia është një bashkësi muslimane, e themeluar në vitin 1889 nga Hazret Mirza Ghulam Ahmedi[as], i cili deklaroi se është Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu. Ardhja e tij në *kohë të mëvonshme* ishte parashikuar nga Profeti Muhammed[sas]. Qëllimi kryesor i këtij xhemati është që të largojë paragjykimet dhe keqkuptimet që i janë veshur Islamit gjatë rrjedhave të kohës dhe t'u tregojë njerëzve Islamin e vërtetë, që është paqësor, tolerant dhe i praruar me spiritualitet, i njëjti Islam që u përcoll dhe u praktikua edhe nga Profeti Muhammed[sas]. Duke iu shmangur fanatizmit të verbër, Xhemati Musliman Ahmedia dënon të gjitha format e dhunës dhe terrorit që kryhen në emër të fesë.

Ky xhemat, i përbërë nga dhjetëra milionë anëtarë, sot gjendet në më shumë se 200 vende të botës dhe konsiderohet si një prej bashkësive më dinamike brenda Islamit. Aktualisht ky xhemat udhëhiqet nga Hazret Mirza Masrur Ahmedi[aba], Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar.

Për pyetje rreth Islamit dhe Xhematit Musliman Ahmedia, ju lutemi na kontaktoni në numrin e gjelbërt. Ky komunikim pa pagesë (nga çdo numër fiks apo celular) funksionon çdo ditë të javës nga ora $08^{00}$ - $20^{00}$.

**0800 1889**


**Adresa:**
Rr. “Pavarësia”
Kutia postare 8176
Mëzez, Tiranë
darulfalah@gmail.com

**Kontaktoni:**
+355 67 21 68054
+355 66 29 74992
+355 69 58 76901


**www.alislam.al**

Leaflet "Muslims for Freedom, Peace & Loyalty" in Albanian

Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd.

www.alislam.al

# Muslimanët për LIRINË PAQEN BESNIKËRINË



“Atdhedashuria është pjesë e besimit”.



Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as] (1835-1908)
Mesih i Premtuar dhe themelues
i Xhematit Musliman Ahmedia

**"Përhapni paqe në Tokë".**

(Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as] në librin e tij "*Government angrezi aur xhihad*".)

> Xhemati Musliman Ahmedia
> është rilindje e Islamit, i themeluar
> nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as],
> që ka deklaruar të jetë
> Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu,
> për të cilin Hazret Profeti Muhammed[sas]
> kishte parashikuar të vinte
> në *kohë të mëvonshme.*

**"Ata që e quajnë veten muslimanë
dhe ndërkohë përpiqen
të përhapin Islamin me forcë,
nuk i dinë bukuritë e tij të natyrshme".**

(Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as], "*Tirjakul-kulub*")

**"Nuk ka imponim në fe".**

**(Kurani Famëlartë 2:257)**

Islami është vazhdimi i feve të kaluara dhe nëpërmjet Kuranit dhe Profetit Muhammed[sas] ka përsosur mesazhin shpirtëror të të gjithë profetëve të kaluar. Prandaj, Islami pranon të gjithë profetët e mëparshëm dhe nuk e monopolizon të vërtetën. Mesazhi hyjnor, përmes fesë Islame, ka arritur kulmin dhe përsosmërinë e tij.




**"Më i miri nga ju është ai që trajton
më së miri familjen e tij".**

(Hazret Profet Muhammed[sas], "*Tirmidhiu*")

**"Ai që ka një vajzë, të cilën e rrit
dhe e arsimon në mënyrë të mirë,
do të hyjë në xhenet".**

(Hazret Profet Muhammed[sas], "*Tirmidhiu*")

# Besnikëria ndaj atdheut

**"Një musliman që e njeh
vërtet fenë e tij, gjithmonë
tregohet i sinqertë dhe
i bindur ndaj shtetit, nën hijen
e mëshirshme të të cilit
ai jeton me paqe.
Dallimi i tij fetar nuk e ndalon
atë që t'i bindet dhe
t'i nënshtrohet sinqerisht
shtetit të tij".**

(Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as], "*Tuhfa Kejserijah*", "*Ruhani Khezain*", vëll. 12, f. 281)